



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 35, datë 22.05.2018

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE
NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME KAVAJË SH.A.**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe në Raportin nr. 64/2, datë 15.05.2018, përgatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatoi:

Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. i ka përfunduar afati i licencës në datën 15.03.2017 dhe ushtron veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë nga Enti Rregullator i Ujit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, e ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. ka detyrime të pashlyera të pagesës rregullatore ndaj Entit Rregullator të Ujit në vlerën 5 311 600 (pesë milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë deri në datën 31.12.2017, të cilat burojnë nga kontratat mes Entit Rregullator të Ujit dhe Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. datë 12.01.2009 dhe kontratës datës 26.07.2010.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masave administrative ndaj Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. për kundërvajtjet administrative:

- a) ushtrimi i veprimtarisë pa licencë;
- b) mospagimi i detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator të Ujit.

2. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani